



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 35, date 24/05/2002

**PER  
PROJEKTIN "TE FESTOJME SE BASHKU 1 QERSHORIN"**

---

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2002, pasi shqyrtoi Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, për financimin e projektit "Të festojmë së bashku 1 Qershorin", mbështetur në Ligjin 8652, dt. 31.07.2000, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", neni 10, pika 3 (paragrafi II/C), neni 72, pika 4 (paragrafi II/C) dhe neni 32, (gërma dh), Ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993 "Për Buxhetin Lokal " ndryshuar me Ligjin Nr. 8399 dt. 09.09.1998 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7776, dt. 22.12.1993 "Për Buxhetin Lokal", Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.4 datë 11.02.2002 "Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2002" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

**V E N D O S I**

1. Të miratojë shumën prej 190.300 lekë, për projektin "Të festojmë së bashku 1 Qershorin".
2. Kjo shumë të përballohet nga fondi i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 4, datë 11.02.2002, Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2002" për projekte sociale dhe arsimore.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Aministrimit Financiar, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**